

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve “[K...]” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim [V.R], kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “[S...]” me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.C.nr 328/2016 të datës 13.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.07.2019, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “[S...]” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.C.nr 328/2016 të datës 13.09.2017, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve “[K...]” me seli në Prishtinë ashtu që është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve “[S...]” me seli në Prishtinë, që ne emër të rimbursimit, paditëses t’ia paguaje shumën prej 1,076.40€, me kamatë ndëshkuese prej 12%, duke llogaritur nga paraqitja e padisë, përkatësisht data 24.06.2016, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 170€.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e të paditurës të aprovohet në tërësi si e bazuar, aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi Kompania e Sigurimeve “[K...]” me seli në Prishtinë, me datën 24.06.2016 ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “[S...]” me seli në Prishtinë për kompensimin e dëmit në shumën e përgjithshme prej 1,830.60€ të shkaktuar me aksidentin e trafikut i datës 20.10.2014, në të cilën ka pësuar automjeti i paditësit, me fajin e drejtuesit të automjetit me targa [...] i siguruar nga e paditura. Paditësi ka realizuar zhdëmtimin për të siguruarin në shumë prej 1,830.60 €, dhe si rezultat i kësaj ka kërkuar nga e paditura ti paguaj regresin në shumë prej 1,830.60 € me kamatë ndëshkuese prej 12% si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga policia e sigurimit autokasko me nr.“[...]“ e datës 01.10.2014 me kushtet e përgjithshme të sigurimit të automjetit, shihet se automjeti i markës “Golf” me targa “[...]“, është siguruar, tek pala paditëse, mbi bazën e sigurimit autokasko.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së është jo kontestuese se automjeti i tipit “Golf” me të cilin është shkaktuar aksidenti, ka qenë i pajisur me policë valide të sigurimit nga auto përgjegjësia, të lëshuar nga pala e paditur. Nga librezja e qarkullimit VRD për automjetin e dëmtuar “Golf” me targa “[...]“, shihet se i njëjti ka qenë në pronësi të paditësit dhe valide për qarkullim në ditën e aksidentit. Nga raporti i aksidentit me nr.2014-AT-0485 i datës 20.10.2014, të përpiluar nga Policia e Kosovës, si dhe nga provat e tjera të lëndës shihet se gjatë kohës se sigurimit, gjegjësisht me datën 20.10.2014, ka ndodhur aksident i trafikut në mes të automjetit të siguruar auto kasko dhe një automjeti tjetër të markës “VW” me targa “[...]“. Nga marrëveshja jashtë gjyqësore e datës 11.02.2015, urdhri për transfer i datës 14.03.2015, përfundimi i mjeteve i datës 24.06.2016 me nr.199/14 shihet ujdia që paditësja ka lidhur me palën e e dëmtuar si dhe shuma që iu është paguar të njëjtës për dëmin e shkaktuar. Nga ekspertiza e komunikacionit e datës 25.04.2017 dhe nga konstatimet e ekspertizës ne seancën kryesore të datës 11.07.2017 gjykata mori për bazë ndarjen e përgjegjësisë si shkaktar primar dhe sekondar, me c ‘rast ndau përgjegjësinë në mes pjesëmarrësve në aksident në përpjesëtim në 70-30%, sa i përket çështjes tjetër kontestuese sa i përket rimorkios, gjykata erdhi në përfundim se e njëjta nuk ka qenë obligative të regjistrohet.

Mbi gjendjen faktike të vërtetuar dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 960 paragrafi. 1 159 paragrafi.1 dhe nenin 136 para.1 të LMD-së, gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë i vlerësoi pretendimet ankimore të së paditurës, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Ne rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se përmes ekspertizës së komunikacionit e punuar nga Eksperti “[S.B.]“ të datës 25.04.2017 është vërtetuar se përgjegjës për shkaktimin e aksidentit të trafikut ishte ngasësi i automjetit A ‘VW’, ndërsa është vërtetuar nga ekspertiza së kontribuar sekondar në shkaktimin e aksidentit ka dhëne ngasësi “[F.T.]“ me automjetin “Golf 6” i cili është dashur të këtë më shumë kujdes dhe të ngas mjetin me shpejtësinë adekuate brenda rrezeve të dritës në mënyrë që mos të rrezikojë pjesëmarrësit tjerë në trafik, dhe kështu ka kontribuar në aksident. si dhe sa i përket

lartësisë së dëmit të pësuar nga aksidenti i trafikut gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka aprovuar në shumën prej 1,076.40€ e cila është dëshmuar me urdhër pagesën e lëshuar nga Banka Ekonomike të datës 12.03.2015, pasi që këtë shumë e ka kërkuar edhe paditësi në kërkesëpadi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të së paditurës dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse në bazë të nenit 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia në të cilën është përcaktuar dëmshpërblimi nga përdorimi i mjetit motorik të pasiguruar, paragrafi. 1 e përcakton se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësia ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim dëmi nga Byroja”* dhe paragrafit 2. Se *“ në rast dëmit të shkaktuar nga mjete motorik sipas paragrafit 1. Të po këtij neni Byroja garanton për detyrime në kuadër të limiteve të përcaktuara sipas nenit 13 të këtij ligji”* si dhe nga neni 960 i LMD-së me të cilin përcaktohet se *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”*, andaj në rastin konkret paditësi ka të drejtë të kërkojë regres nga Kompania e Sigurimeve “[S...]”.

Kjo gjykatë i vlerësoi edhe pretendimet tjera të së paditurës, lidhur me lartësinë e normës së kamatës, por gjeti se të njëjtat janë ta pabazuara, ngase neni 26, pika 6, i Ligjit mbi Sigurimin e Detyruar nga Autopergjegjësia, përcakton lartësinë e kamatës prej 12% nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka parashtruar pranë të paditurës kërkesën për kompensim me datë 24.06.2016, dhe sipas dispozitës së cekur kamata rrjedh nga kjo datë, andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,**  
**Ae.nr.257/2017, dt.01.07.2019**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**

**Mahir Tutuli, d.y.**

